

# TE RUASH GJUHEN



IMAM NEVEVIU

## Te ruash gjuhen

Autori: Imam Neueui, rahimehullah

NDALIMI I PERGOJIMIT DHE THASHETHEMEVE  
PIKA ME RENDESI NE LIDHJE ME KUFLITE E PERGOJIMIT  
SI E PARANDALON DIKUSH VETEN E TIJ NGA PERGOJIMI?  
TE RUASH GJUHEN  
CFARE DUHET TE BEJE DIKUSH NESE E DEGJON SE SHEIKHU I TIJ OSE SHOKU OSE DIKUSH TJETER ESHTE DUKE U PERGOJUAR  
PERGOJIMI I ZEMRES  
TA PASTROSH VETEN DHE TE PENDOHESH NGA PERGOJIMI  
LIDHUR ME THASHETHEMET

Allahu, me i larti, thote: "**Nuk e nxjerr nje fjale, veçse ka nje (melaik) duke pare, gati per ta mbajtur shenim**". (Kaf:18)

Dhe thote: "**Me te vertete, Zoti yt shikon çdo gje**". (el-Fexhr:14)

E kam permendur me perpara çfare Allahu ma lehtesoi mua per te folur per llojet e pelqyera te dhikrit. Une gjithashtu doja te perfshija bashke me to gjerat qe jane te papelqyera dhe te ndaluara ne te folurit e dikujt. Kjo per arsy qe ky liber te jete i plete ne lidhje me rregullat e thenieve te personit, dhe i per gjithshem ne lidhje me shpjegimin e llojeve te ndryshme. Keshtu, do te permend disa aspekte per to, te cilat çdo musliman duhet t'i kete parasysh. Shumica e gjerave qe do te permend jane te njobura mire, dhe per kete arsy nuk do t'i permend dëshmitë. Keshtu, me Allahun qendron i gjithe suksesi.

Ta dish se çdo njeri qe bie ne kategorine e te qenit i per gjegjshem per veprat e tij, duhet ta ruaje gjuhen nga te gjitha llojet e te folurit, perveç per ate te folur qe ka perfitim. Keshtu, ne situaten kur te flasesh a te mos flasesh jane ne baraspeshe, atehere Sunneti eshte qe te mos flasesh fare. Kjo eshte per arsy se te folurit e lejuar (ne baraspeshe me te ndaluarin) e hap rrugen drejt asaj qe eshte e ndaluar, dhe te mundohesh me u ruajtur, ne ate grade, nuk e letheson aspak.

Ebu Hurejrah, radiAllahu anhu, transmeton se Profeti (salallahu alejhi ue selem) tha: "**Kush beson Allahun dhe Diten e Fundit, le te flase mire ose le te heshte**". Bukhari 11/308 nga el-Fet'h dhe Muslimi 47

Ky hadith, per te cilin dijetaret kane rene dakord per vertetesine e tij, eshte prove e qarte se personi nuk duhet te flase, perveç kur e folura e tij eshte e mire dhe kur e folura e tij ka me shume perfitim. Keshtu, nese dikush eshte ne dyshim se nese e folura e tij eshte me perfitime, atehere ai nuk duhet te flase.

Imam Shafi'i, rahimehullah, tha: "Kur dikush deshiron te flase, atehere eshte detyre e tij te mendoje para se te flase. Nese ka diçka me vlere ne ate qe ka per te thene, atehere mund te flase; nese ka dyshim rreth asaj, atehere nuk duhet te flase derisa ta sqaroje dyshimin e tij".

Ebu Musa el-Esh'ari, radiAllahu anhu, transmeton: "**O Profeti i Allahut (salallahu alejhi ue selem) cili nga muslimanet eshte me i mire?" Ai u per gjigj: "Ai, nga gjuha dhe dora e te cilit muslimanet jane te sigurte**". Bukhari 1/54 ne el-Fet'h dhe Muslimi 42.

Sahl ibn Sa'ad, radiAllahu anhu, transmeton se Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka thene: "**Kush me siguron mua (se do te ruaje) çfare ka ne mes te dy faqeve (gjuha) dhe çfare ka ne mes te dy kembeve, une ia siguroj xhennetin**". Bukhari 11/308 ne el-Fet'h.

Ebu Hurejrah, radiAllahu anhu, transmeton se Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka thene: "**Me te vertete robi do te flase nje fjale duke mos patur kujdes dhe per shkak te saj do te hidhet ne zjarr te xhehennemit, nga nje largesi sa lindja e perendimi**". Bukhari 11/308 ne el-Fet'h dhe Muslimi 2988.

Ne transmetimin e Bukharit, eshte vetem me fjalet "**...me larg sesa distanca nga perendimi**" pa e permendur lindjen. Kuptimi i "**...duke mos patur kujdes**" eshte se ai nuk ndalon e te mendoje se nese e folura e tij eshte e mire apo e keqe.

Ebu Hurejrah, radiAllahu anhu, transmeton se Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka thene: "**Me te vertete robi do te flase fjale qe e kenaqin Allahun, per shkak te se ciles do t'i jepet nje pozite me te cilen Allahu do ta ngreje ne shume grada. Dhe me te vertete robi do te flase fjale qe nuk e kenaqin Allahun, per shkak te se cilave nuk do t'i jepet nje pozite e mire, por (perkundrazi) do te hidhet ne zjarr**". Bukhari 11/308 ne el-Fet'h.

Transmetohet ne Muatta te Imam Malik, rahimehullah, dhe ne librat e et-Tirmidhi, rahimehullah, dhe Ibn Maxheh, rahimehullah, nga Bilal ibn Harith el-Muzni, radiAllahu anhu, se i Derguari i Allahu (salallahu alejhi ue selem) ka thene: "**Me te vertete nje njeri do te flase me fjale qe e kenaqin Allahun, te cilave ai nuk u kushton vemendje se çfare do te fitonte nga ato, dhe per shkak te saj Allahu do ta shenoje per te ne Kenaquesine e Tij deri ne diten qe e takon Ate. Dhe me te vertete nje njeri do te flase me fjale qe nuk e kenaqin Allahun, te cilave ai nuk u kushton vemendje se çfare do te fitonte nga ato, dhe per shkak te saj Allahu do ta shenoje ate tek pakenaesia e Tij deri ne diten qe e takon Ate**". Sahih - Transmetohet nga et-Tirmidhi 2420 te Tuhfeh el-Ehuedhi, Ibn Maxheh 3970 dhe Malik 2/985 nga rruga e Muhammed ibn Amr.

Sufjan ibn Abdil-lah, radiAllahu anhu, transmeton se ai ka thene: "**O i derguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) me thuaj mua nje gje qe ta kapem fort pas saj**". Ai tha: "**Thuaj: Besoj ne Allahun dhe qendro i forte (ne kete)**". Une i thashe: "**O i derguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) cila eshte gjeja më me rendesi qe duhet t'i frikesohem nga vetja ime?**" Keshtu, ai e kapi gjuhen e tij dhe tha: "**Kete**". Sahih - Transmeton et-Tirmidhi 2522 te Tuhfeh el-Ehuedhi, Ibn Maxheh 3972 dhe Ahmed 3/413 nga ez-Zuhri nga Muhammed ibn Abdurr-Rrahman ibn Ma'iz nga Sufjan ibn Abdil-lah eth-Thakafi. Muslimi 2/8-9 te Sherh Neueui e transmeton nga rruga e Hisham ibn Uruah... Se bashku hadithi eshte i vertete per shkak te rrugeve te ndryshme te transmetimit. Jam i habitur sesi autori nuk e ka permend kete hadith tek Sahih Muslim, ku edhe gjendet.

Ibn Umeri, radiAllahu anhu, transmeton se i derguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) ka thene: "**Mos flisni shume pa e permendur Allahun, sepse me te vertete te folurit e shumte pa e permendur Allahun i forcon zemrat. Dhe me te vertete njerezit qe jane me larg nga Allahu jane ata qe i kane zemrat e forcvara**". Da'if, transmetohet nga et-Tirmidhi 2523 dhe 2524 nga rruga e Ibrahim ibn Abdullah ibn Hatib nga Abdullah ibn Dinar nga Ibn Umeri. et-Tirmidhi ka thene: "Ky eshte hadith i çuditshem. Nuk e dime kete hadith vetem se nga rruga e Ibrahim ibn Abdullah ibn Hatib. Une (Sheikh Selim el-Hilali, hafidhehullah) them: "Ai eshte Ibn Abdullah ibn el-Harith ibn Hatib el-Xhumhi. Ibn Ebi Hatim e permend ate ne Xhehr ue Te'dil 2/110, por as nuk e ka aprovuar as nuk e ka kritikuar. edh-Dhehebi e permendi ne Mizan el-Itidal 1/41 dhe e permendi kete trasnmetim si transmetim te vetem. Pastaj tha: "Nuk di asnje kritike kundra tij". Une (Sheikh Selim el-Hilali, hafidhehullah) them: "Mosdituria se ka apo s'ka kritike ndaj tij, nuk e ben ate me

domosdo te besueshem. Imam Malik e permend ne Muuatta 2/986 si thenie e Isa ibn Merjem, alejhi selam.

Ebu Hurejrah, radiAllahu anhu, transmeton se Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka thene: "**Kujt i jepet mbrojtja nga Allahu nga e keqja qe ka ne mes te dy faqeve dhe nga e keqja qe ka ne mes te dy kembeve, do te hyje ne xhennet**". (9) Tirmidhi ka thene se eshte hadith hasen. Sahih - transmetohet nga et-Tirmidhi 2521 te Tuhfeh el-Ehuedhi, nga rruga e Ibn Ixhan nga Ebu Hazim. Une (Sheikh Selim el-Hilali, hafidhehullah) them: "Senedi eshte hasen, sepse Muhammed ibn Ixhan eshte i ndershem. Muslimi transmeton prej tij nga transmetimet e tija keshilluese. Keshtu, hadithi eshte sahih per shkak te provave mbeshtetese.

Ukbah ibn Amir, radiAllahu anhu, transmeton: "Thashe: "**O i derguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) si e arrin dikush shpetimin?**" Ai tha: "**Permbaje gjuhen tende, rri ne shtepine tende dhe qaj per mekatet e tua**". (10) Sahih – transmeton Ibn el-Mubarak ne ez-Zuhd 134 dhe nga ai Ahmedi 5/259 dhe et-Tirmidhi 2517 te Tuhfeh el-Ehuedhi nga rruga e Ubejdullah ibn Zuhr nga Alii ibn Jezid. Une (Sheikh Selim el-Hilali, hafidhehullah) them: "Senedi eshte shume i dobet, sepse ka dy defekte ne te. E para, Ubejdullah ibn Zuhr ka dobesi dhe e dyta, Alii ibn Jezid eshte shume i dobet. Sidoqofte, Ahmedi 4/148 e transmeton ate nga rruga e Mu'adh ibn Rifa'ah nga Alii ibn Jezid. Keshtu, defekti i pare ngrihet per shkak se Mu'adh eshte i ndershem. Gjithashtu et-Taberani 59 e transmeton nga rruga e eth-Theuban nga babai i tij nga el-Kasim nga Ebu Umamah. Senedi eshte hasen, keshtu qe defekti i dyte ngrihet.

Ebu Se'id el-Khudrij, radiAllahu anhu, transmeton se Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka thene: "**Kur biri i Ademit zgjohet nga gjumi, te gjitha pjeset e trupit te tij kerkojne mbrojtje nga gjuha e tij duke thene: "Ki frike Allahun ne lidhje me ne, sepse ne jemi pjese e jotja. Nese ti je e drejte edhe ne jemi te drejtje dhe nese ti je e prishur edhe ne do te prishemi**". (11) Hasen - transmetohet nga et-Tirmidhi 2518 te Tuhfeh el-Ehuedhi, Ahmedi 3/95-96, Ibn el-Mubarak ne ez-Zuhd 1012 dhe te tjere, nga rruga e Hamad ibn Zejd nga Ebu Subha nga Sa'id ibn Xhubejr. Senedi i tij eshte hasen, transmetuesit jane te gjithe te besueshem perveç Ebu Subhas. Emri i tij eshte Suhejb dhe ai ishte skllavi i liruar i Ibn Abbasit. Ebu Zur'ah dhe Ibn Hibban e deklaruan te besueshem dhe shume kane transmetuar nga ai. Keshtu, hadithet e tij jane te pranueshme.

Umm Habibah, radiAllahu anha, transmeton se Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka thene: "**Çdo fjale e birit te Ademit eshte kundra tij e jo me te, perveç urdherimit ne te mire e ndalimit nga e keqja, si dhe permendja e Allahut, i lartesuar qofte**". (12) Da'if - transmetohet nga et-Tirmidhi 2525 te Tuhfeh el-Ehuedhi, ibn Maxheh 3974 nga rruga Muhammed ibn Bishar. Ky hadith eshte i dobet per shkak se ka dy defekte. E para eshte Umm Salih, gjendja e saj eshte e panjohur. E dyta eshte Muhammed ibn Jezid el-Khanis.

Mu'adh ibn Xhebel, radiAllaha anhu, transmeton: "Une i thashe: "**O i derguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) Me thuaj per nje veper qe do te me çoje ne xhennet dhe do te me largoje nga zjarri**". Ai tha: "Me ke pyetur per nje çeshtje te madhe, por eshte lehte per ate qe Allahu, i lartesuar qofte, ia lehteson. Duhet ta adhurosh Allahun, duke mos shoqueruar asnje me te; duhet te falesh namazin dhe ta japesh zekatin, duhet te agjerosh Ramadanin dhe te kryesh Haxhin tek Shtepia". Pastaj tha: "A t'i tregoj ty hyrjet e miresise? Agjerimi eshte mburoje, sadakaja i shuan mekatet ashtu si uji e shuan zjarrin, dhe gjithashtu (kete e ben) namazi i njeriut ne thellesine e nates". Pastaj ai recitoi: "Largohen nga shtreterit e tyre duke qare te Zoti i tyre me frike e shprese, dhe shpenzojne nga ato qe Ne i kemi dhene atyre. Asnje shpirt nuk e di se çfare eshte mbajtur ne fshehtesi nga lumturia, si shperblim per ate qe benin". (es-Sexhdeh:16)

Pastaj ai (salallahu alejhi ue selem) tha: "A ta them kreun e çeshtjeve, shtyllen dhe pjesen me te larte?" I thashe: "Po, O i derguari i Allahut". Ai tha: "Kreu i çeshtjeve eshte Islami, shtylla eshte namazi, dhe pjesa me e larte eshte xhihadi. A te them se çfare e kontrollon te gjithe kete? Une thashe: "Po, O i derguari i Allahut". Ai e kapi gjuhen e vet dhe tha: "Permbaje kete!" Une i thashe: "O i derguari i Allahut, a do te merremi ne llogari per ate qe themi?" Ai tha: "Te humbte nena, o Mu'adh. A ka diçka qe i ben njerezit te zvarriten me fytyrat e tyre - ose ai tha - me hundet e tyre ne zjarr veçse frytet e gjuheve te tyre". (13) Sahih - Transmeton et-Tirmidhi 2616, Ibn Maxheh 2973 dhe Ahmedi 5/231 nga rruga e Mu'amar prej Asim ibn Ebi Nuxhud nga Ebu Ua'il. Ahmedi 5/235-236 gjithashtu e transmeton nga rruga e Shahr. Une (Sheikh Selim el-Hilali hafidhehullah) them: "Senedin e ka te dobet, sepse Shahr ka patur kujtese te dobet. Ahmedi 5/234 gjithashtu e transmeton nga rruga e Ibn el-Mugiras. Une (Sheikh Selim el-Hilali hafidhehullah) them: "Senedin e ka te dobet sepse Ebu Bekri, qe eshte Abdullah ibn Ebi Mejrem esh-Shami, ua ngaterronte transmetimet e tij. Por, transmetuesit e tjere jane te besueshem. Keto rruge te ndryshme transmetimi e forcojne njera-tjetren, nese do Allahu.

Ebu Hurejrah, radiAllahu anhu, transmeton se Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka thene: "**Prej islamit te mire te dikujt eshte qe te braktise gjerat qe nuk i interesojne**". (14) Sahih - Transmeton Malik 2/903 me rrugen e tij, et-Tirmidhi 2420 qe eshte: nga ibn shihab nga Ali ibn el-Husejn nga Ali. Une (Sheikh Selim el-Hilali, hafidhehullah) them: "Transmetuesit jane te besueshem vetem se hadithi eshte mursel. et-Tirmidhi 2419 dhe Ibn Maxheh 2976 e transmetojne nga rruga e Euzait. Une (Sheikh Selim el-Hilali, hafidhehullah) them: "Senedi eshte hasen, transmetuesit jane te besueshem, perveç Kurrah ibn Abdurr-Rahman ibn Hejuid. Ne permblehdje hadithi eshte i vertete per shkak te transmetimeve te tjera dhe evidencave nga nje grup sahabesh..."

Abdullah ibn Amr ibn As, radiAllahu anhu, transmeton se Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka thene: "**Kush hesht, ai eshte i shpetuar**". (15) Sahih - Transmeton et-Tirmidhi 2618, ed-Darimi 2/99 dhe Ahmedi 2/159 dhe 177 nga rruge te ndryshme nga Ibn Lehi'ah. et-Tirmidhi ka thene: "Hadith i çuditshem, nuk e kemi degjuar perveç nga transmetimi i Ibn Lehi'as". Ai ka qellim se hadithi eshte i dobet, sepse Ibn Lehi'ah ka kujtese te dobet. Dhe autori (Neueui) ka rene dakord me te. Sidoqofte, disa kane transmetuar nga ibn Lehi'ah dhe transmetimet e tyre nga ai jane te verteta. Ibn el-Mubarak e transmeton kete ne ez-Zuhd 385 dhe gjithashtu ibn Uahb ne el-Xhami 2/85. Ne fund, hadithi eshte i vertete.

Persa i perket transmetimeve nga Selefet rreth kesaj çeshtjeje, atehere ato jane te shumta. Nuk ka nevoje te permenden ato pasi kemi permendur hadithet e meparshme. Sidoqofte, do te permendim disa prej tyre.

Na ka arritur se Kass ibn Sa'ada dhe Ekthem ibn Sejfi u takuan dhe njeri i tha tjetrit: "Sa te meta ke mundur te gjesh tek biri i Ademit?" Tjetri tha: "Jane te shumta qe te numerohen, sidoqofte, **te metat qe munda te numeroj ishin 8 mijë**. Zbulova edhe nje gje qe nese e ve ne praktike, te gjitha keto te meta do te jene te fshehura. Ai pyeti: "Cila eshte" Ai u pergjigj: "**Te ruash gjuhen**".

Ebu Ali Fudejl ibn Ijjad tha: "**Kush i perkufizon fjalet e tij te jene ne perputhje me veprat e tij, do ta zvogeloje te foluren e tij ne ate qe nuk i intereson**".

Imam Shafi'i i tha nxensit te tij, Rebi'ut: "**O Rebi'i! Mos fol per gjerat qe nuk te interesojne, sepse me te vertete çdo here qe e flet nje fjale, ajo (fjala) te kontrollon ty e ti nuk ke kontroll mbi te**".

Abdullah ibn Mes'ud, radiAllahu anhu, ka thene: "**Nuk ka asgje qe meriton te burgoset me shume sesa e meriton gjuha**".

Te tjere kane thene: "**Shembulli i gjuhes eshte si i nje kafshe te eger: Nese nuk e fut ne kafaz, do te shkoje kundra teje**".

Ebul Kasim el-Kushejri ka thene ne te famshmen Risalah: "**Te heshtesh eshte shpetim dhe eshte nga parimet baze. Te rrish i qete ne kohet e duhura eshte cilesi e burrerise, ashtu si te folurit kur eshte koha te flasesh eshte nga gjerat me fisnike**".

Dhe ai tha: "**E degjova Ebu Alij ed-Dahak qe tha: "Kush rri i heshtur ne lidhje me te verteten, ai eshte nje shejtan i heshtur"**".

Ai gjithashtu tha: "Persa i perket pelqimit te atyre qe mundohen me bere mire duke heshtur, atehere kjo eshte sepse ata i dine pasojat e keqija te te folurit dhe se shpirterat jane te kenaqur me te (te folurin). Eshte gjithashtu per shkak te cilesive te lavderueshme qe do te tregoje dhe se do ta beje ate te shkoje drejt dallimit te tij dhe llojit te tij, qofte te folurit e mire ose e kunderta. Kjo eshte cilesi e atyre qe kane devotshmeri fetare, dhe eshte nje nga shtyllat e edukimit te njerezve. Çfare eshte thene ne poezi per kete eshte:

Ruajeni gjuhen, o njerez

Dhe mos e leni t'ju kafshoje, se ajo eshte nje gjarper

Sa shume njerez ne varret e tyre jane, qe jane vrare nga gjuhet e tyre

Kush ka frike ne takimin me Te - eshte ai qe eshte trim.

#### **NDALIMI I PERGOJIMIT DHE THASHETHEMEVE**

Dije se keto dy gjera jane nga me te uletat dhe te qortueshmet nga te gjitha gjerat, megjithkete me te perhapurat midis njerezimit, ne ate menyre saqe asnjeri nuk eshte i lire pej tyre (pergojimit dhe thashethemeve) perveç disa njerezve.

Sa per pergojimin (ghibah) atehere ajo eshte kur te permendesh diçka rreth nje personi (ne mungese te tij) te cilen ai e urren (te permendet) qofte kjo ne lidhje me trupin e tij, karakteristikat fetare te tij, punet e tij te dunjase, vetes se tij, pamjes se tij te fizike, karakterit te tij, pasurise se tij, femise se tij, babait te tij, gruas se tij, sherbetorit te tij, skllavit te tij, kokores se tij, veshjes se tij, menyres se tij te ecjes, buzeqeshjes se tij, mungeses se moralit te tij, vrenjesise se tij, gazit te tij, ose ndonje gje tjeter e lidhur me kete qe thame me lart. Po ashtu, eshte e njejtë nese e permendni keto gjera per te me fjale, nepermjet shkrimeve, ose nese ju veni ne dukje ose tregoni ate duke bere gjeste me syte tuaj, dore, apo koke.

Sa per trupin, atehere kjo eshte kur ju thoni: "ai eshte i verber", "ai çalon", "ai eshte sy-turbullt", "ai eshte tullac", "ai eshte i shkurter", "ai eshte i gjate", "ai eshte i zi", "ai eshte i verdhe". Sa per cilesite e tij fetare, atehere kjo eshte kur ju thoni: "ai eshte mekatar", "ai eshte hajdut", "ai eshte tradhtar", "eshte shtypes", "ai e merr namazin lehesisht", "ai nuk kujdeset per papastertite", "ai nuk sillet mire ndaj prinderve te tij", "ai nuk e paguan zekatin ashtu siç duhet" dhe, "ai nuk eviton shpifjen". Sa per çeshtjet e kesaj bote, atehere kjo eshte kur ju thoni: "ai ka sjellje te keqija", "ai eshte i shkujdesur ndaj njerezve", "ai nuk mendon se ndonjeri ka te drejte mbi te", "ai flet shume", "ai han dheflen shume", "ai flen ne kohe jo te duhura", "ai ulet ne vendet qe nuk i perket te ulet".

Sa per çeshtjet lidhur me prinderit e ndonjerit, atehere kjo eshte kur ju thoni:"babai i tij esht mekatar", "Indian", "Nabatean", "Negro (zezak)", "qe rri kot", "mbjelles", "shites gjedhesh", "marangoz", "farketar", "thures". Sa per karakterin e tij, atehere kjo eshte kur ju thoni:"ai ka sjellje te keqija", "ai eshte arrogant", "ai eshte grindavec", "ai nxiton dhe ngutet", "ai eshte tiran", "ai eshte i dobet", "ai ka zemer te dobet", "ai eshte i papergjegjshem", "ai eshte i mjere", "ai eshte i shthurur", etj. Sa per veshjen, kjo eshte kur ju thoni:"ai ka menge te gjera", "i ka te shkurtra te kthyerat e robes", "sa veshje e papaster", e keshtu me radhe.

Kategorite e ngelura mund t'i nxjerrim bazuar mbi ate qe permendem, duke konsideruar qe burimi i rregullit pas tij eshte:"Zenia ne goje e disa aspekteve rreth tij, te cilat ai urren t'i permenden". Ebu Hamid el-Ghazali citoi renien dakord te dijetareve Islame ne lidhje me pergojimin, e cila eshte:"Permendja e njerezve tjere nga ndonjeri (ne mungese te tyre) me diçka qe ata e urrejne t'u permendet". Hadithi i vertete qe qarteson kete do te jepet me vone.

Sa per thashethemet (nanimah) atehere kjo eshte kur ndonjeri bart fjalet e njerezve nga nje grup i individeve tek nje tjeter, me qellim per te shkaktuar rremuje midis atyre te dyve.

Keto jane perkufizimiet e te dyjave. Sa per vendimet e tyre, atehere ato jane te ndaluara bazuar ne pajtimin e njezeshem te dijetareve Islame. Evidenca e qarte ne Kur'an, Sunnet dhe konsensusin e ummetit tregon ndalimin e saj. Allahu thote:

**"Dhe mos pergojoni njeri-tjetrin"** (el-Huxhurat:12)

Dhe Ai thote:

**"Mjere per keto qe shpif dhe pergojon"** (el-Humezeh:1)

Dhe Ai thote:

**"Perojues, qe bart shpifje (nder njerez)".** (el-Kalem:11)

Hudhejfe (ra) transmeton se Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka thene: "**Ai i cili perhap thashetheme (namam) nuk do te hyje ne Xhennet**". (Sahih - Transmetuar nga el-Bukhari (10/472 ne el-Fet'h) dhe Muslimi (105) dhe perpilimi eshte nga ai).

Ibn 'Abbas (ra) transmeton se i Derguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) njehere kaloi afer dy varreve dhe tha: "**Me te vertete ata (te vdekurit ne ato varre) te dy Jane duke vuajtur dhe ata nuk po vuajne per diçka te madhe**".

Ne transmetimin e el-Bukhari thuhet: "**Mirepo, kjo vertet eshte diçka e madhe. Sa per te parin, ai shkontakte rreth e rrotull duke perhapur thashetheme (namam) dhe sa per tjetrin, ai nuk e mbronte veten nga urina e tij**". (Sahih - Transmetuar nga el-Bukhari (1/317 dhe 322, 3/222 - 223 dhe 242) dhe Muslimi (292)).

Dijetaret thone se kuptimin i "**dhe ata nuk po vuajne per diçka te madhe**" eshte: "**diçka e madhe**" sipas opinionit te tyre ose "**diçka e madhe**" per ata qe ta lene ate.

Ebu Hurejre (ra) transmeton se i Derguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) njehere tha (shokeve ti tij): "**A e dini ju se çka eshte pergojimi**"? Ata thane: "Allahu dhe i Derguari i Tij e dine me mire". Ai tha: "**Zenia ne goje e diçkaje rreth vellait tuaj (ne mungese te tij) te cilen ai e urren (ti permendet)**". I eshte thene: "Çfare ne qofte se ajo ekziston te vellai im, ajo e cila une them (per

te)"? Ai (salallahu alejhi ue selem) tha:"**Ne qofte se ju gjeni tek ai ate çka thoni, atehere ju e keni pergojuar ate; ne qofte se ajo çfare thoni nuk gjendet tek ai, atehere ju i keni shpifur atij**". (Sahih - Transmetuar nga Muslimi (2589).

Ebu Bekr (ra) transmeton se i Derguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) tha ne hutben e tij ne diten e Kurbanit, gjate haxhit lamtumires:**"Me te vertete gjaku juaj, pasuria juaj dhe nderi juaj jane te shenjta per ju, mu siç kjo dite e juaja eshte e shenjte, ne kete toke tuajen, ne kete muaj tuajin. A nuk e percolla (porosine tek ju)?"** (Sahih - Transmetuar nga el-Bukhari (1/199 tek el-Fet'h).

'A'ishah (ra) transmeton:"I thashe Profetit (salallahu alejhi ue selem): Ti je me i gjate se Safija per kaq e kaq (disa nga transmetuesit thone se kjo nenkupton se ajo ishte e shkurter)". Keshtu qe ai (salallahu alejhi ue selem) tha:**"Ti ke thene nje fjale, e cila po te perzihet me ujin e detit, sigurisht do ta njolloste ate"**. (Sahih - Transmetuar nga Ebu Daud (4875) et-Tirmidhi (2624 tek et-Tuhfah dhe Ahmed (6/189) nga rruga e Sufjan Ibn 'Ali Ibn el-Akmar. Une them: Zinxhiri i tij i transmetimit eshte i vertete, transmetimet e tij Jane te besueshme).

et-Tirmidhi tha se ky hadith ishte hasan sahih. Une them se fjala per njollosjen (mazaxha) do te thote: Qe ajo (thenia e saj) po te perzihej me ujin me nje perzierje te tille, ajo (thenia) do ta ndryshonte shijen dhe eren e tij per shkak te sertesise se kuterbimit dhe poshtersise se saj (fjales). Ky hadith eshte nje nga provat me te medha per pohimin e ndalimit te pergojimit, ne mos me e madhja (prove). Dhe une nuk di asnje tjeter hadith qe arrin kete nivel lidhur me denimin e pergojimit.

**"Dhe ai (profeti) nuk flet nga deshira e tij (e vete atij). Kjo eshte vetem Shpallje qe i shpallet".** (en-Nexhm:3-4).

I kerkojme Allahut, me Bujarit, per butesine dhe faljen e Tij per te gjitha veprat e neveritshme.

Enes (ra) transmeton se i Derguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) ka thene:**"Kur une u ngrita (ne qiej) hasa ne nje populli qe i kishte thonjt e tunxhit, me te cilet ato gervishnin fytyrat dhe gjoksat e tyre. Keshtu qe une thashe: 'Kush Jane keta njerez, o Xhibril'? Ai tha: 'Ata Jane te cilet hane mishin e njerezve dhe i çnderojne ata'"**. (Sahih - Transmetuar nga Ahmed (3/224) Ibn Ebi ed-Dunja tek es-Samat (165-572) nga Ebul-Mughirah. Eshte transmetuar gjithashtu nga Ebu Dawud (4878 - 4879) Thene shkurt, hadithi ne formen meusul eshte i vertete dhe Allahu e di me se miri).

Eshte transmetuar gjithashtu nga Se'id Ibn Zejd (ra) se Profeti (salallahu alejhi ue selem) ka thene:**"Me te vertete nje nga format me te keqija te Ribase (interesit) eshte poshterimi i nje Muslimani pa te drejte"**. (Sahih - Transmetuar nga Ebu Dawud (4876) Ahmed (1/190) dhe el-Hejthem Ibn Kuleib ne el-Musned (2/30) nga rruga e 'Abdullah Ibn Ebi Husein nga Nawfil Ibn Mesahik. Une them: Ky zinxhir i transmetimit eshte i vertete - te gjithe transmetuesit e tij Jane te besueshem. Hadithi ka deshmi ndihmese nga hadith tjeter transmetuar nga el-Bera Ibn 'Azib, 'Abdullah Ibn Mesud, dhe 'Abdullah Ibn 'Abbas (ra). Shiko et-Targhib (3/503 - 505).

Ebu Hurejreh (ra) transmeton se i Derguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) ka thene:**"Muslimani eshte vella i Muslimanit tjeter. Ai nuk e tradhton ate, as nuk e genjen, as nuk e braktis. Gjithçka e Muslimanit tek (tjetri) Musliman eshte e shenjte: nderi i tij, pasuria e tij dhe gjaku i tij. Takwa (frika dhe bindja tek Allahu) eshte mu ketu (duke treguar nga gjoksi i tij). Mjafton si e keqe per nje person qe ta shikoje me perçmim shokun e tij Musliman"**. (Sahih - Transmetuar nga et-Tirmidhi (1992) nga Hisham Ibn Sa'ad nga Zejd Ibn

Aslam nga Ebu Salih. et-Tirmidhi e deklaron ate hasen, dhe eshte siç ai thote. Ka nje transmetim tjeter qe njoftohet nga Muslimi (2564) dhe Ahmed (2/277, 311 dhe 360) nga Ebu Se'id. Autori (ra) ka harruar te permend keto rruge te transmetimit).

et-Tirmidhi tha se eshte hadith hasen. Une them se nuk ka ndonje hadith me te madh ne perparesti dhe me më shume ne pikat te perfitimit se sa ky hadith. Dhe me Allahu eshte i gjithe suksesi.

#### PIKA ME RENDESI NE LIDHJE ME KUFIJTE E PERGOJIMIT

Ne kapitullin e meparshem thame se pergojimi eshte kur nje njeri permend diçka per nje njeri tjeter (ne mungese) te cilen ky i fundit nuk e pelqen qe te permendet, qoftë ajo duke perdorur fjale, shkrime, ose duke bere gjeste per te treguar se mendon ne te, ose duke e treguar ate me sy, me dore a me koke.

Direktivat e tij: Çdo gje qe i ben te tjeret t'i kuptojne te metat ne nje musliman, atehere ajo eshte pergojim qe eshte i ndaluar. Shembull per kete eshte kur dikush u thote te tjereve se filani çalon, ecen shtrember ose diçka te ngjashme me kete, me te te cilave personi do qe ta poshteroje personin tjeter. E gjithe kjo eshte Haram dhe nuk ka mendim tjeter per kete gje. Nje shembull tjeter eshte kur nje autor permend nje person te veçante ne librin e tij, duke thene: "... filani thote keshtu e ashtu...". duke deshiruar me kete qe ta degradoje dhe ta çnderoje ate. Kjo eshte Haram. Mirepo, nese qellimi eshte qe te sqarohet gabimi i atij personi qe ai te mos ndiqet (gabimi i tij) ose te sqarohet mungesa e dijes tek ai qe te mos lajthise te tjeret dhe mendimet e tia te merren per baze, atehere kjo nuk eshte pergojim, por eshte keshille, e cila eshte detyre dhe per te cilen do te shperblehet nese vertet qellimi i tij ka qene per te (per te dhene keshille, jo per te degraduar).

Gjithashtu, nese autori ose dikush flet ne per gjithesi, duke thene: "keta njerez" ose "ky grup thote kete e kete", dhe kjo eshte "gabim", ose "moskuptim", ose "pakujdesi", ose e ngjashme me kete, atehere kjo nuk eshte pergojim. **Pergojim eshte vetem kur dikush flet per nje person te caktuar ose nje grup njerezish (duke ia permendur emrin).**

Gjithashtu prej llojeve te ndaluara te pergojimit eshte:

Kur dikush thote: "Disa njerez bene kete dhe kete", ose "disa nga dijetaret", ose "disa qe pohojne se kane dije", ose "disa nga multite", ose "disa qe ia ngjesin veten atyre qe udhezozne (ummetin)", ose "ata qe pohojne zuhd (asketizem)", ose "disa njerez qe na shperfillen sot", ose "disa njerez qe i pamet sot", ose te ngjashme me kete "... bene kete e kete", pa specifikuar asnjeri, por ai te cilil eshte duke iu folur e mer vesh se kush jane keta njerez per shkak se foleti ia mundeson qe ta kuptoje se kush jane ata (permes fjaleve qe thote).

Gjithashtu prej atyre llojeve eshte: Te pergojosh te devotshmit dhe personat e dijes, se vertet ata i kthehen pergojimit duke e bere kete ne menyren qe i bene te tjeret te kuptojne (se per ke behet fjale pa e veçuar ate) mu siç kuptohet diçka qe eshte e qarte. Per shembull, kur i thuhet njerit prej tyre: "Si eshte filani?" Ai per gjigjet: "Allahu na permiresofte", ose "Allahu e udhezofte", ose "Lusim Allahun ta pale!", ose "Falenderojme Allahun qe nuk na ka sprovuar me hyrjen ne erresire", ose "Kerkojme mbrojtjen e Allahut nga e keqja", ose "Allahu na ruajte nga modestia e paket", ose "O Allah, na e prano pendimin", dhe çfare eshte e ngjashme me kete, me ane te se cilave personi i kuption te metat e tjedit. Te gjitha keto jane nga llojet e ndaluara te pergojimit. Njelloj eshte nese dikush thote: "Filani eshte duke u sprovuar me ate me te cilien te gjithe kemi qene te sprovuar", ose "pasuria e tij eshte mjet per kete sprove", ose "te gjithe e kemi bere ate veper".

Keto jane llojet e shembujve lidhur me kete çeshtje. Dhe nese nuk eshte keshtu, atehere ne duhet te kthehem prapa tek parimi baze i pergojimit, i cili eshte: "**Dikush qe i ben degjesit te kuptojne mangesite qe kane disa njerez (edhe pa permendjen e emrave te tyre) ashtu siç e kemi permendor me perpara**". Te gjitha keto jane kuptuar nga kushtet e hadithit ne Sahih Muslim, qe e kemi permendor ne kapitullin e meparshem, gjithashtu edhe ne te tjere, ne lidhje me kufijte e pergojimit. E Allahu e di me se miri.

Ta dish se ne te njejtmenyre qe pergojimi eshte i ndaluar per ate qe e flet, gjithashtu eshte e ndaluar per ate qe e degjon apo e aprovon ate. Keshtu, eshte e detyrueshme per ate qe degjon nje njeri duke u zhytur ne formen e ndaluar te pergojimit, ta ndaloje ate nga te berit e kesaj vepre per sa kohe qe nuk ka frike ndonje te keqe te hapur per shkak te kesaj (ndalese). Por nese ka frike prej ndonje te keqeje, atehere eshte i detyruar qe ta kundershtoje me zemren e tij dhe te largohet nga ai mexhlis nese mundet. Nese ka mundesi qe ta ndaloje me gjuhen e tij ose ta perfundoje pergojimin duke e ndryshuar temen, atehere kjo behet detyre e tij. Dhe nese nuk ben asnje nga keto, atehere ai ka bere nje veper mosbindjeje (dmth mekat).

Nese ai thote me gjuhen e tij: "Hesht!" por duke dashur me zemren e tij qe te vazhdohet (pergojimi) atehere Ebu Hamid el-Gazali ka thene: "Kjo eshte hipokrizi. Kjo nuk e largon njeriu nga mekati qe e ben. Por, ai duhet ta urreje me zemer".

Nese eshte i detyruar qe te rri ne ate mexhlis ne te cilin pergojimi po behet, dhe ka frike qe ta kundershtoje, ose e kundershton por nuk i vihet veshi dhe nuk ka rruge qe te ndahet nga ata, atehere ai eshte i ndaluar qe te degjoje dhe t'i kushtoje vemendje pergojimit. Në vend kesaj, ai duhet te perkujtoje Allahun (dhikr) me goje e zemer ose vetem me zemer. Ose, ai duhet te mendoje per diçka tjeter ne menyre qe te jete i zene nga degjimi i tij (pergojimi). Pasi ta kete bere kete, degjimi i tij pa ia vere veshin apo pa i kushtuar vemendje (te folures) nuk do ta demtoje ate, kur ai te jete ne kete gjendje. Nese ka mundesi pas kesaj qe te largohet prej tyre dhe ata akoma jane duke pergojuar, atehere largimi nga ata eshte i detyrueshem. Allahu thote:

**"Dhe kur i sheh ata qe hyjne ne biseda boshe ne lidhje me ajetet Tona duke u tallur me to, largohu nga ata derisa te hyjne ne nje bisede tjeter. E nese shejtani te ben te harrosh, atehere pasi te te kujtohet mos rri ne shoqerine e njerezve zullumqare"**. (el-En'am:68)

Eshte transmetuar se Ibrahim ibn Edhem njehere ishte ftuar ne nje uelimah (dasem) keshtu qe shkoi dhe i gjeti njerezit duke permendor nje person qe nuk kishte ardhur. Ata thane: "Ai eshte pertac". Ibrahim i tha: "Ia solla kete gje vetes time, saqe erdha ne nje vend ky njerezit pergojojnë njeri-tjetrin". Ai iku prej aty dhe nuk hengri per tre dite. Çfare eshte recituar si poezi ne lidhje me kete eshte:

E ruaji veshte e tu nga degjimi i fjaleve te keqja

Ashtu siç e ndalon gjuhen tende nga te folurit e saj (te folures se keqe)

Sepse kur e degjon fjalen e keqe

Ti je shok i atij qe e thote ate, keshtu qe mendohu

Dije se kjo pjese konsiston ne shume evidenca nga Kur'ani dhe Sunneti, megjithate, une do ta shkurtoj ate duke permendur vetem disa nga ato. Keshtu, kujdo qe i eshte dhene suksesi nga Allahu, ai do te kete perfitim nga ato; dhe kujdo qe nuk i eshte dhene suksesi, atehere ai nuk do te perfitoje nga ato, edhe pse ai do te shikonte volume perplot me keto prova.

Vatra kryesore e ketij kapitulli eshte qe çdo individ te (lexoje) zbatoje te gjitha tekstet qe kemi thene lidhur me ndalesen e pergojimit dhe mandej te thellohet ne fjalet e Allahut:

**“Nuk ka fjale qe ai (njeriu) e nxerre nga goja, veçse per te eshte nje vezhgues prane tij i gatshem (per ta shenuar ate)”. (Kaf:18)**

Dhe fjalet e Tij:

**“Dhe ju e konsideruat ate (shpifjen) si gje te vogel, ndersa tek Allahu ajo eshte shume e madhe”. (en-Nur:15)**

Dhe hadithin e vertete qe permendem me pare:

**“Me te vertete robi mund te thote nje fjale nga e cila perftohet zemerimi i Allahut, ndersa ai nuk e kupton ate. Dhe per shkak te saj, ai do te gjuhet brenda ne Zjarrin e Xhehennemit”.**  
(Sahih - I permendur me lart)

Ai gjithashtu duhet te thellohet ne te gjitha provat qe kemi thene ne kapitujt e meparshem ne ruajtjen e gjuhes dhe pergojimit. Eshte mbi çdo individ t'i bashkengjese dhe zbatoje keto (tekste) te gjitha ne fjalet e tij, ne menyre qe (t'i thote vetes se tij para se te flase): “Allahu eshte me mua”, “Allahu eshte duke me deshmuar mua”, “Allahu eshte duke me shikuar mua”.

Nje njeri njehere i tha Hasan el-Basriut: “Ti me ke pergojuar mua”. Keshtu qe ai tha: “Cili je ti, qe te mund te di tek cili jane duke shkuar veprat e mia te mira?”

Dhe ‘Abdullah Ibn el-Mubarak tha: “Ne qofte se do te pergojoja ndonje, sigurisht do te pergojoja prinderit ngase ata kane me se shumti te drejte (te marrin) veprat e mia te mira”.

#### TE RUASH GJUHEN

#### CILAT LLOJE TE PERGOJIMIT JANE TE LEJUESHME?

Dije se megjithese pergojimi eshte i ndaluar, ai behet i lejueshem ne disa rrethana te veçanta kur kjo behet per arsyte te dobishme. Lejimi per ta bere ate duhet te jete i bazuar ne nje arsyte te vlefshme dhe legjitime pa te cilien lejueshmeria (e pergojimit) nuk mund te arrihet. Lejimi (per berjen e pergojimit te lejueshem) mund te jete ndonjera nga gjashte arsyet qe vijoje:

**1. Shtypja** - Eshte e lejueshme per ate qe eshte shtypur te ankohet rreth gjendjes se tij tek sunduesi ose gjyqtari, ose cilido tjeter qe mban autoritetin ose ka mundesine t'i jape atij drejesine kunder shtypesit te tij. Ai duhet te thote: “Filan personi me beri padrejtesi” dhe “ai me beri te tillen gje mua”, dhe “ai me shtrengoi mua ne kete menyre” dhe keshtu me rradhe.

**2. Kerkuarja e ndihmes per ndryshimin e nje te lige dhe ne rikthimin e mekatarit tek ajo qe eshte e drejte.** - Dikushi duhet t'i thote individit per te cilin ai mendon se ka aftesine per te ndaluar te keqen: “Filan njeri beri kete, keshtu qe une e parandalova ate nga ajo” ose diçka e ngjashme me

kete. Objektivi i tij duhet te jete kerkimi i menyres per t'i dhene fund te keqes perfundimisht. Ne qofte se ai nuk ka per qellim kete, atehere eshte e ndaluar (per te ta permende ate).

**3. Kerkimi i nje fetwaje (gjykimi fetar)** - Ai duhet ta beje kete duke i thene muftiut (dijetarit qe ka aftesine per te dhene fetwa): "Babai im" ose "Vellai im" ose "Filan personi me beri padrejtesi mua", "A ka ai te drejte te beje keshtu", "Si duhet te veproj per t'i dhene fund kesaj dhe te ruaj te drejten time nderkohe qe po largoj shtypjen nga vetja ime?" e keshtu me radhe. Po ashtu, dikushi mund te thote: "Gruaja ime ma beri keshtu e keshtu", ose "burri im e beri kete e kete", e keshtu me rradhe. Kjo eshte e lejueshme per shkak te domosdoshmerise se saj, megjithate per te qene me shume te kujdeshem, eshte me mire per ndonjerin te thote: "Çka thoni ju per nje njeri, i cili vepron kete e ate gje?" ose "persa i takon nje burri" ose "persa i takon nje gruaje, e cila ka bere kete e ate" (pa thene "e imja") etj.

Duke bere kete, qellimi eshte arritur duke mos pasur nevoje te saktesojme asnjerin. Megjithate, saktesimi i me emer i ndonje individi eshte e lejueshme (ne kete rrethane) bazuar ne hadithin e Hindes (ra) te cilin do ta permendim me vone, ne dashte Allahu, ne te cilin ajo i tha te Derguarit te Allahut (salallahu alejhi ue selem): "**Me te vertete Ebu Sufjani (burri i saj) eshte doreshtrenguar**". Dhe i Derguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) nuk e ndaloj ate ta thote kete.

**4. Paralajmerimi dhe Keshillimi i Muslimaneve kunder se liges** - Jane disa perspektiva tek kjo, nga te cilat njera eshte: Deklarimi i ndonjerit i pabesueshem ne fushen e transmetimit te hadithit dhe dhenien e deshmise. Kjo eshte e lejueshme sipas Ixhma'se (renies dakord te dijetareve Islame). Me sakte, kjo behet e obligueshme per shkak te nevojes. Nje tjeter rast eshte kur nje njeri deshiron te hyje ne marredhenie me nje tjeter person ose nepermjet marteses, tregtise, transferimit te pasurise, transferimin e diçkaje tek ai, ose tek ndonje tjeter nga punet e perditshme. Eshte e obligueshme per ju te permendni tek ai njeri çfare ju dini rreth personit me te cilin ai deshiron te kete marredhenie, me qellimin qe ta keshillosh ate.

Ne qofte se objektivi juaj mund te arrihet thjesht duke thene: "Nuk eshte mire per juve te angazhoheni me te ne transaksionet financiare" ose "ne nje marredhenie martesore" ose duke thene: "Ju nuk duhet ta beni kete" ose ndonje gje te ngjashme me kete e pastaj te thoni diçka me shume se kjo, siç eshte permendja e karakteristikave te keqija te tij, kjo nuk eshte e lejueshme. Dhe ne qofte se objektivi nuk nund te arrihet, perveç duke ia shpjeguar saktesisht gjendjen e ketij personi atij, atehere ju mund t'ia permendni atij detalisht. Nje tjeter rast eshte kur ju shikoni ndonjerin duke blere nje produkt nga nje person, i cili eshte i njohur per vjedhje, kurveri, ose pijanec, ose diçka tjeter perveç ketyre. Atehere, juve ju takon qe te informoni bleresin e ketij (produkti) duke ditur se nuk ka dije rreth saj tashme. Dhe ky rast nuk eshte i specifikuar vetem ne kete shembull. Me sakte, kjo zbatohet gjithashtu kur jeni ne dijeni se malli qe po tregtohet eshte me defekt. Atehere, eshte e obligueshme per ju t'ia qartesoni kete çeshtje bleresit, ne qofte se ai nuk di per ate.

Tjeter rast eshte kur shihni nje nxenes duke shkuar tek nje bidatçi ose i devijuar per te kerkuar dituri nga ai, dhe frikesohesh se kjo mund te kete efekt tek nxenesi. Ne kete situate, ju duhet ta keshilloni ate rreth gjendjes se atij bidatçiu, me kushtin qe qellimi juaj te jete vetem per hir te keshillimit. Dhe kjo eshte diçka ne te cilen shume njerez gabojne, se ndoshta personi qe flet mund ta beje kete (keshille) sepse ai ka xheloz (ndaj personit qe ai po paralajmeron). Ose ndoshta shejtani mund ta mashtroje ate rreth kesaj çeshtjeje, duke shkaktuar qe ai te besoje qe ajo qe po ben eshte keshille dhe shfaqje e dhembshurise, keshtu qe ai beson ne kete.

Rasti i fundit eshte kur nje person ka nje rol udheheqes, i cili nuk i permbush si duhet detyrat ose per shkak se nuk eshte i pershatshem per te, ose per shkak se eshte mekatar ose neglizhent etj. Keshtu qe ne kete rast, duhet permendor kete atyre qe kane pushtetin e pergjithshem mbi kete person, keshtu qe ai te heqet dhe dikush qe eshte i pershatshem te mund te vihet ne detyre. Ose ata te cilet kane perjegjesi mbi te, te dine kete rreth atij, keshtu qe ata te merren vesh me te si duhet dhe te mos mashtrohen nga ai, keshtu qe ata te bejne perpjekjet e duhura per ta inkurajuar ate qe te jete i drejte ose ta zevendesojne ate.

**5. Kur ndonjeri haptazi ekspozon aktet e tij te keqija ose bidatin e tij** - Nje shembull i kesaj eshte kur ndonjeri haptazi konsumon alkoolin, ose konfiskon ilegalisht parate e njerezve, ngrit taksat padrejtisht dhe merr pushtet ne menyre te paligjshme. Keshtu eshte e lejueshme per ndonjerin te flase rreth asaj se çfare ka bere ky individ publikisht. Pra, eshte e ndaluar permendja e te metave tjera qe ai ka, perveç nese bien ne njerien nga kategorite, te cilat permendem rreth lejimit te pergojimit.

**6. Percaktimi i dikujt** - Ne qofte se ndonjeri eshte i njohur tek njerezit nga llagapi i tij si "ai qe ka syte e turbullt", "ai qe çalon", "djali i shurdhet", "djali i verber", "vengerosh", "ai qe ka hunde te rrafshet", dhe te tjera pos ketyre, atehere eshte e lejueshme ta veçosh ate si te tille, me qellim per ta identifikuar ate. Mirepo, eshte e ndaluar te praktikohet kjo tek ai kur qellimi i ndonjerit eshte ta degradoje ate. Ne qofte se ai mund te identifikohet me nje tjeter (me te pershatshem) lloj emri, atehere kjo eshte me e preferueshme.

Keto jane gjashte rastet ne te cilat dijetaret kane deklaruar se pergojimi eshte i lejuar, ne qofte se ajo eshte bere ne sipas udhezimeve te permendura me lart.

Nga ata qe kane transmetuar te njeten me ate çka ne permendem, eshte Ebu Hamid el-Ghazali ne librin e tij "el-Ihja", po ashtu dhe dijetare te tjere. Provat per lejueshmerine e pergojimit mund te gjenden ne te vertetin dhe te mirenjohurin ahadith. Per me teper, ekziston nje renie dakord midis dijetareve persa i perket lejimit te pergojimit ne keto gjashte raste.

Eshte transmetuar se ne Sahihet e el-Bukhari-ut dhe te Muslimit se A'ishah (ra) ka thene: "Nje njeri i kerkoi leje Profetit (salallahu alejhi ue selem) per te hyre (ne shtepine e tij) keshtu qe ai tha: **'Lereni ate te hyje, dhe sa vella i lig per te afermit (e tij) ai eshte'**". (Sahih - Transmetuar nga el-Bukharee (10/471 nga el-Fet'h) dhe Muslimi (2591).

el-Bukhari e perdon kete hadith si nje prove per lejueshmerine e pergojimit per njerezit e lig dhe me dyshime.

Ibn Mes'ud (ra) transmeton: "I Derguari i Allahut (salallahu alejhi uen selem) ndau nje pjese (nga plaçka e luftes) keshtu qe nje njeri nga Ensaret tha: 'Betohem ne Allahun se Muhammedi nuk ka per qellim fytyren e Allahut duke bere kete (sh.p. ai nuk ishte i drejte)'. Keshtu une shkova tek i Derguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) dhe e informova ate rreth kesaj. Fytyra e tij ndryshoi (sh.p. u zemerua) dhe tha: **'Allahu e meshirofte Musain. Ai me te vertete eshte abuzuar me më shume se kjo, por ai ishte saberli (i durueshem)'**". (Sahih - Transmetuar nga el-Bukhari dhe Muslimi dhe eshte kontrolluar me lart)

Ne disa nga transmetimet e ketij hadithi Ibn Mes'ud (ra) tha: "Une thashe: Nuk do t'i tregoj më tjeter hadith atij, pas kesaj".

el-Bukhari e perdon kete hadith si prove qe nje person eshte i lejuar te informoje vellane e tij se çfare eshte thene rreth tij.

A' ishah (ra) transmeton se i Derguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) njehere e nje kohe ka thene: "**Une nuk mendoj se filani apo filani di ndonje gje rreth Fese tone**". (Sahih - Transmetuar nga el-Bukhari (10/485 el-Fet'h).

el-Laith Ibn Sa'ad, nje nga transmetuesit e zinxhirit te hadithit thote: "Ata ishin dy individe nga mesi i hipokriteve (ne ate kohe)".

Zejd Ibn Arkam (ra) transmeton: "Dolem jashte ne nje ekspedite me Profetin (salallahu alejhi ue selem) dhe njerezit vuanin shume (per shkak te mungeses se furnizimit). Keshtu, 'Abdullah Ibn Ubej (Sh.p. Ai ishte lideri i hipokriteve ne Medine. Me rastin e vdekjes se tij Allahu zbriti ajetet duke komanduar Profetin (salallahu alejhi ue selem) mos t'i fale namazin e xhenazes atij) u tha shokeve te tij: 'Mos shpenzoni per ata qe jane me te Derguarin e Allahut (salallahu alejhi ue selem) derisa ata ta braktisin ate'. Ai tha: 'Ne qofte se ne kthehemini ne Medine, sigurisht, me i ndershmi do ta deboje qe andej me te uletin (te Derguarin e Allahut (salallahu alejhi ue selem)). Keshtu une shkova te Profeti (salallahu alejhi ue selem) dhe e informova ate rreth kesaj. Ai dergoi dike per te pyetur 'Abdullah Ibn Ubejd, por 'Abdullah Ibn Ubej u betua se nuk i kishte thene ato fjalet. Keshtu njerezit thane: 'Zejdi i tha nje genjeshter te Derguarit te Allahut (salallahu alejhi ue selem)'. Dhe çka ata thane me shkaktoi vuajtje shume! Me vone Allahu zbriti konfirmimin e pohimit tim ne fjalet e Tij: '**Kur Munafiket (hipokritet) vijne tek ti...**'. (el-Munafikin, Sahih - Transmetuar nga el-Bukhari (8/664 dhe 646-648 tek el-Fet'h) dhe Muslimi (2772).

Po ashtu eshte edhe hadithi i Hindes (ra) gruas se Ebu Sufjanit, ne te cilin ajo i tha Profetit (salallahu alejhi ue selem): "**Me te vertete Ebu Sufjan eshte doreshtrenguar**". (Sahih - Transmetuar nga el-Bukhari (9/504 tek el-Fet'h) dhe Muslimi (1714).

Dhe gjithashtu ne hadithin e Fatimah Bint Kajs (ra) kur Profeti (salallahu alejhi ue selem) i tha asaj (lidhur me pranimin e propozimeve per martese nga ana e saje, nga dy kerkues): "**Sa per Mu' awine, ai eshte krejtesisht i varfer. Dhe sa per Ebu Xhehmin, ai nuk pushon se hequri shkopin nga supi i tij (i rrahe grate e veta)**". (Sahih - Transmetuar nga Muslimi (1480).

#### ÇFARE DUHET TE BEJE DIKUSH NESE E DEGJON SE SHEIKHU I TIJ OSE SHOKU OSE DIKUSH TJETER ESHTE DUKE U PERGOJUAR

Ta dish se eshte detyre e çdokujt kur degjon se nje musliman po merret neper goje, qe ta kundershtoje dhe ta ndaloje ate qe pergojon. Nese nuk ka mundesi ta ndaloje me fjalet e tija, atehere ta ndaloje me doren e tij. Nese nuk ka mundesi as me doren e tij e as me gjuhen e tij, atehere ai duhet te ngrihet e te largohet nga ai mexhlis. Dhe nese e degjon se mesuesi i tij eshte duke u pergojuar - ose dikush tjeter qe ka perparesti mbi te, ose nese personi (qe po merret neper goje) eshte prej njerezve te devotshem dhe fisnik, atehere shqetesimi i tij me çfare permendem me lart duhet te jete akoma me i madh.

Ebu ed-Derda, radiAllahu anhu, transmeton se Profeti, salallahu alejhi ue selem ka thene: "**Kush largohet (nga demtimi) i nderit te vellait te tij, Allahu do t'ia largoje fytyren e tij nga zjarri i xhehennemit ne diten e gjykimit**". Hasen ose Sahih- Transmeton et-Tirmidhi 1996, Ahmed 6/450, ed-Deulabi ne el-Kuna 1/124 dhe Ibn Ebi Dun'ja ne es-Samet 250 nga rruga e Ebu Bekr en-Behsheli nga Merzuk ibn Ebi Bekr et-Tejmi nga Umm Derda. et-Tirmidhi tha se eshte hasen hadith. Une them: "Eshte ashtu siç thote ai, duke kuptuar se ai kishte per qellim se ky hadith ka nje sened te dobet, por eshte transmetuar me rruge te tjera qe nuk kane te meta, ashtu siç ai e shpjegon ne pjesen e fundit te Sunenit te tij. Pra, referoju kesaj sepse eshte me rendesi. Kjo eshte sepse te gjithe transmetuesit e hadithit jane te besueshem, perveç Merzuk. Edh-Dhehebi tha: "Askush nuk transmetoi prej tij, perveç Ebu Bekr en-Nehsheli". Sidoqofte, el-Hafidh (Ibn Haxher) tha ne et-The'dhib 10/87: "Mendoj se ai eshte qe vjen me pas". Pastaj ai tha: "Duke dalluar: Merzuk, Ebu

Bukejr et-Temimi el-Kufi. Ai transmeton nga Se'id ibn Xhubejr, Ikrimeh dhe Muxhahid. Dhe Lejth ibn Ebi Sulejmi, Israili, Umer ibn Muhammed ibn Zejd el-Umeri, eth-Theuri dhe esh-Sherik transmetuan nga ai. Ibn Hibban e permend ate ne librin e tij eth-Thikat (Te Besueshmit). Me origjine ai eshte nga Kufa, por jetoj ne Rrajj". Dhe ai (Ibn Haxheri) tha ne biografine e tij, se ai eshte i besueshem. Keshtu, dissa nxenes dije e keqkuptuan kete nga el-Hafidh, por nuk ka arsy per kete keqkuptim, sepse el-Hafidh mendoi se Ebu Bekri i pare ishte i dyti (Ebu Bekejri). Keshtu qe nese keta dy emra i referohen te njejtin njeri, siç mendoi el-Hafidh, dhe kjo me duket e qarte edhe mua, atehere hadithi eshte i vertete. Dhe nese Jane dy njerez te vecante, atehere hadithi eshte hasen, sepse Merzuk eshte i pranueshem kur transmetohet nga rruga e Shehr ibn Heusheb.

Dhe eshte transmetuar ne Sahih Bukhari dhe Muslim nga Itban, ose disa thone Utban-ne, hadithin e tij te gjate e te famshem, ne te cilin tregon: "Profeti salallahu alejhi ue selem u çua te falet, e njerezit thane: "Ku eshte Malik ibn ed-Dukshum!" Nje njeri tha: "Ai hipokrit! Allahu e i derguari i Tij nuk e duan ate". Keshtu Profeti, salallahu alejhi ue selem, tha: "**Mos e thuaj ate! A nuk e sheh se ai thote La ilahe ia Allah, duke kerkuar me kete Ftyren e Allahut?"** (34) Sahih - Transmeton Bukhari 1/518, 2/157 dhe 172 dhe 323, 3/60-61, 11/241, 12/303 te el-Fet'h dhe Muslimi 33.

Dhe eshte transmetuar ne Sahih Muslim nga el-Hasan el-Basri se A'idh ibn Amr, radiAllahu anhu, nje nga sahabet e te derguarit te Allahut, salallahu alejhi ue selem, hyri ne pranine e Ubejdullah ibn Zijadit dhe tha: "O biri im, me te vertete e kam degjuar te derguarin e Allahut, salallahu alejhi ue selem, qe tha: "**Me te vertete kujdestaret me te keqinj jane udheheqesit zulumqare, keshtu qe ki kujdes qe te mos behesh prej tyre".**

Keshtu ai (Ubejdullah ibn Zijadi) i tha atij (A'idh ibn Amr, radiAllahu anhu): "Ulu aty, sepse ti je vetem nga mbeturinat e pavlera prej sahabeve te Muhammedit!" Keshtu ai (A'idh ibn Amr, radiAllahu anhu) iu pergjigj: "A ka patur mbeturina te pavlera prej tyre? Madje, mbeturinat e pavlera u shfaqen vteem pas tyre nga mesi i te tjereve". (35) Sahih - Transmeton Muslimi 1830.

Ka'ab ibn Malik, radiAllahu anhu, ne hadithin e tij te gjate ne lidhje me pendimin e tij, tha se kur Profeti, salallahu alejhi ue selem, po rrinte me disa njerez ne Tebuk tha: "**Çfare beri Ka'ab ibn Malik?"** Nje njeri nga Benu Selima tha: "**O i Derguari i Allahut! Bukuria e rrobes se tij dhe vleresimi i vetes se tij e mashtruan ate dhe e penguan (qe te vinte e te luftonte ne kete beteje)!"** Pasi degjoi kete, Mu'adh ibn Xhebel, radiAllahu anhu, i tha atij: "**Çfare gjeje te keqe ke thene! Pasha Allahun, o i derguari i Allahut, ne nuk dime per te asgje veçse te mira".** Keshtu, i Derguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, nuk foli". (36) Sahih - Trasnmeton Bukhari 8/113-116 dhe Muslimi 2769.

Xhabir ibn Abdullah dhe Ebu Talha, radiAllahu anhum, thane: "I Derguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, tha: "**Nuk ka (musliman) njeri qe e braktis nje musliman tjeter ne nje vend ku shenjteria e tij eshte marre neper kembe dhe nderi i tij eshte perulur, veçse Allahu do ta braktise ate ne nje vend qe ai do te donte te kishte mbrojtjen (ndihmen) e Tij. Dhe nuk ka (musliman) njeri qe e ndihmon nje muslimani tjeter ne nje vend ku shenjteria e tij eshte marre neper kembe dhe nderi i tij eshte perulur, veçse Allahu do ta ndihmoje ate ne nje vend qe ai e do mbrojtjen (ndihmen) e Tij".** (37) Da'if - Transmeton Ebu Daud 4884, Ahmed 4/30, el-Bejheki 8/167-168, Ebu Nu'ajm ne el-Hiljah 8/189 dhe Ibn Ebi Dun'ja ne es-Samet 241 nga rruga e Lejth ibn Sa'ad. Une them: "Senedi eshte i dobet, sepse Jahja ibn Selim dhe sheikhu i tij, Isma'il ibn Beshir, Jane te dy te panjohur.

Mu'adh ibn Enes, radiAllahu anhu, transmetoi se Profeti, salallahu alejhi ue selem, tha: "**Kush e mbron nje besimtar prej nje munafiku, Allahu do te dergoje nje engjell qe do t'ia ruaje mishin atij ne diten e gjykimit nga zjarri i xhehennemit. Dhe kush e akuzon nje musliman per**

**diçka duke deshiruar qe ta poshteroje ate, Allahu do ta mbaje ate ne uren siper xhehennemit derisa ta marre mbrasht ate qe ka thene".** (38) Hasen -Transmeton Ebu Daudi 4883, Ahmed 3/441, el-Bagaui ne Sherh es-Sunnah 13/105 dhe Ibn Ebi Dun'ja ne es-Samet 248 nga rruga e ibn el-Mubarak. Une them:"Senedi eshte i dobet, sepse Isma'il ibn Jahja el-Mi'afari eshte ne te dhe ai eshte i panjohur. Sidoqofte, ky hadith ka prova mbeshtetese qe e ngrejne ate ne nivelin e te qenurit i pranueshem. Shiko et-Tergib 515-520. Shenim me rendesi:"Sheikhu yne (el-Albani) e ka permendur kete hadith tek Da'if el-Xhami's-Sagir 5/193 si hadith te dobet, por pastaj ai e vleresoi si hasen (me vone) ne Sahih Sunen Ebi Daud 4086. Vleresimi i fundit eshte i sakte, keshtu qe dije kete gje.

#### **PERGOJIMI I ZEMRES**

Dije se pasja e mendimeve te keqija per dike eshte e ndaluar mu sikur te flasesh keq per te. Keshtu, sikur qe eshte e ndaluar per juve te flisni me te tjeret rreth mangesive te nje personi, po ashtu eshte e ndaluar t'i flisni vetes tuaj rreth saj dhe te kesh mendime te keqija per te. Allahu thote:

**"O ju qe keni besuar! Menjanoni shume dyshime. Vertet, disa nga dyshimet perbejne gjynahe".** (el-Huxurat:12)

Dhe Ebu Hureira (ra) transmeton se i Derguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) ka thene:**"Kini mendjen nga dyshimi, se me te vertete dyshimi eshte me e paverteta fjale"**. (Sahih - Transmetuar nga el-Bukhari (10/484 tek el-Fet'h) dhe Muslimi (2563).

Hadithet me te njejtin kuptim qe kam permendur ketu jane te shumte. Pergojimi i zemres eshte: Kur zemra ka bindje te thelle dhe mban mendime te keqija per dike. Por sa per idete qe rastesisht shfaqen ne mendjen e dikujt, ose kur ky dikushi flet me veten e tij, atehere deri sa keto mendime nuk mbeten te ngulura dhe te vazhdueshme tek ai, eshte i justifikuar sipas konsesusit te dijetareve. Kjo eshte sepse ai nuk ka zgjedhje tjeter lidhur me kete, keshtu qe ai nuk mund ta ndaloje ate te ndodhe dhe as nuk mundet te gjeje nje tjeter menyre te çliroje veten e tij nga kjo kur kjo ndodh. Ky eshte kuptimi i asaj qe ka qene provuar ne te vertete (ne tekste).

I Derguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) ka thene:**"Me te vertete Allahu e ka bere te lejueshme per ummetin tim ate çka shpirterat e tyre u pershperisin atyre, deri sa ata nuk e flasin ate (ne menyre te degjueshme) ose nuk e veprojne ate"**. (Sahih - Transmetuar nga el-Bukhari (5/160 tek el-Fet'h) dhe Muslimi (127 dhe 202).

Dijetaret thone:"Kjo u referohet ideve qe formohen ne mendjen e dikujt, por qe nuk nguliten ose nuk vendosen aty".

Dhe ato thone:"Kjo eshte pavaresisht ne qofte se mendimet konsistojne ne pergojim, mosbesim e keshtu me radhe (sh.p. eshte e falur perderisa nuk eshte vendosur). Keshtu (p.sh) mendja e cilitdo qe vershohet nga mendimet e mosbesimit, por ato jane vetem mendime, pa pasur per qellim qe ai t'i nxjerre jashte ato (mendime) dhe mandej i heq qafe keto mendime menjehere sapo ato te ndodhin, ai nuk eshte mosbesimtar as nuk ka ndonje mekat per te".

Ne tashme kemi thene me pare, ne kapitullin e pershperitjeve (te brendshme) hadithin e vertete ne te cilin Sahabet thane:"O i Derguar i Allahut! Disa nga neve gjejne gjera ne mendimet e tyre qe jane te tmerrshme per t'u folur". Keshtu ai (salallahu alejhi ue selem) tha:**"Ky eshte vertetim i besimit"**. (Sahih - Transmetuar nga Muslimi (123).

Dhe kjo vlen dhe per transmetimet e tjera qene kemi permendor ne ate kapitull, i cili ka te njejtin kuptim.

Arsyet per justifikimin e ketyre mendimeve eshte per shkak te asaj qe kemi permendor me pare, se keto mendime jane te pamundura te parandalohen. Me sakte, dikushi eshte i afte vetem te parandaloje keto mendime nga ngulitja dhe vendosja ne mendjen e ketij. Kjo eshte pse vendosja dhe gjykimi ne zemra nga keto mendime eshte e ndaluar.

Keshtu, kurdo qofte qe keto mendime, te cilat konsistojne ne pergojim ose ne ndonje mekat tjeter, jane te pranishme ne mendjen tende, eshte e obligueshme per juve t'i zmbrapsni ato, te ikni prej tyre dhe te kerkoni falje dhe shpjegime qe do te ndryshojne ate qe eshte e dukshme.

Ebu Hamid el-Ghazali tha ne el-Ihja:"Ne qofte se mendimet e keqija vine ne zemren tende, atehere ato jane nga pershperitjet e shejtanit, te cilat ai i ka vendosur ne ty. Keshtu qe ju duhet t'i mohoni dhe t'i refuzoni ato, sepse ai me te vertete eshte me i ligu i keqbereseve (fasik). Dhe Allahu ka thene:

**"Ne qofte se nje njeri i lige e i poshter (fasik) ju vjen juve me ndonje lajm, verifikojeni ate qe te mos demtoni njerezit nga padija dhe pastaj te ndjeni keqardhje per çfare bete".** (el-Huxhurat: 6).

Pra, nuk eshte e lejueshme per juve te besoni Iblisin (Shejtanin).

Dhe ne qofte se eshte ndonje shenje qe tregon se ai eshte i prishur, megjithkete ai le te kuptohet te kunderten e saj, atehere nuk eshte e lejueshme te keshe mendime te keqija (per te).

Midis shenjave qe tregojne se ndonjeri mban mendime te keqija (per dike) eshte se zemra juaj ndryshon karshi atij nga menyra se si ka qene me pare, dhe se ti i largohesh atij dhe ai behet i padurueshem (per ju). Dhe se ju beheni dembel kur vjen puna qe te interesoheni per te, te shfaqet dashamiresi nda tij dhe te brengoseni kur ai ben pune te liga. Dhe me te vertete Shejtni vjen afer zemres se ndonjerit kur edhe gjurma me e vogel e te metave shfaqet ne njerez, dhe ai i vendos ato tek juve, nderkohe qe ju mendoni (se keto mendime) ndodhin per shkak te mendjemprethesise suaj, inteligences dhe syçeltesise. Por, besimtari shikon me driten e Allahut. Keshtu qe ky person ne realitet flet me mashtrimet dhe kurthet e liga te shejtanit.

Edhe ne qofte se nje person i besueshem ju informon per kete, atehere mos i besoni atij por as mos e hidhni poshte ate, me qellim qe most te keni mendime te keqija per te dy ata.

Kurdo qofte qe disa mendime te liga rreth nje Muslimani vine ne mendjen tende, atehere le t'ju beje kjo ta shtoni interesimin dhe dashamiresine tuaj ndaj tij, sepse kjo do te zemeroje Shejtanin dhe do ta zmbraps ate nga juve. Keshtu, ai nuk do te vendose mendime te tilla tek juve me vone nga frika ajo vetem do te jete shkak qe ju te shtoni lutjet tuaja per ate person.

Dhe kurdo qofte qe merr vesh per mangesi ose gabim tek nje Musliman tjeter bazuar ne disa prova, te cilat nuk mund te mohohen, atehere keshillojeni ate ne fshehtesi dhe mos e leni Shejtanin t'ju mashtroje ne menyren qe ai t'ju ftoje dhe t'ju udheheq drejt pergojimit te tij. Dhe kur ta qortoni ate, mos e qortoni ate nderkohe qe ju jeni i gezuar dhe i kenaqur qe ju keni dijeni per mangesine e tij. Keshtu qe kjo te jete sikur ai eshte duke shikuar tek juve me syte e tmerrit dhe respektit nderkohe qe ju jeni duke shikuar me perçmim me syte e harbutit. Me sakte, ki qellimin ne kete qe ta çlironi ate nga ky mekat, nderkohe qe ju jeni i brengosur per te, ashtu sikur jeni i brengosur kur ndonje e mete

gjindet tek ti. Dhe largimin nga ana e tij e kesaj mangesie pa pasur nevoje qe ta qortoni ate (nga vetja e tij) duhet te jete me e dashur tek juve sesa ai te pastroje veten e tij si shkak i qortimit tuaj".

Keto jane dy fjalet e el-Ghazali. Une them:"Ne thame me pare se, ne qofte se tek ndonjeri eshte e pranishme ideja a mendimeve te keqija per nje tjeter person, ai duhet t'i nderprese keto mendime te keqija. Por kjo eshte nese nuk ka ndonje perftim (fetar) te ligjeruar qe na ben te mendojme (rreth ketij personi) ne kete menyre. Keshtu, ne qofte se nje arsy e tille ekziston, mbajtja e ketyre mendimeve rreth mangesive te tij eshte e lejueshme, po ashtu paralajmerimi kunder ketyre, siç mund te shihet ne xhehr (kriticizmin) e deshmitareve te veçante, transmetuesve dhe te tjereve qe ne i kemi permendur ne Kapitullin "Cilat Lloje te Pergojimit Jane Te Lejueshme"".

#### TA PASTROSH VETEN DHE TE PENDOHESH NGA PERGOJIMI

Dije se eshte e detyrueshme per çdo njeri qe e ben nje mekat qe te nxitoje e te pendohet per ate (mekat). Pendesa ne lidhje me te drejtat e Allahut duhet te plotesoje tre kushte:

1. Duhet te ndalet nga berja e mekatit menjehere.
2. Duhet te ndjeje brengosje dhe pendese per shkak te kryerjes se atij mekati, dhe
3. Duhet te merr vendim qe te mos kthehet me ne ate mekat.

Pendesa ne lidhje me te drejtat e njerezve duhet te plotesoje tre kushtet e mesiperme e gjithashtu edhe nje te katert, qe eshte:

4. Te terheqet çfaredo zullumi qe eshte shkaktuar ne dike ose te kerkohet falje nga personi per zullumin (qe i eshte bere nga ju).

Pra, eshte e detyrueshme per personin qe ka bere pergojimin te pendohet ne baze te ketyre kater kushteve, sepse pergojimi perfshin te drejtat e njerezve, keshtu qe ai duhet te kerkoje faljen e personit qe e ka pergojuar.

A eshte e mjaftueshme qe (pergojuesi) te thote vetem:"Te kam pergojuar, te lutem me fal", apo duhet ta njoftoje se çfare ka thene per te?

Ka dy mendime rreth kesaj tek dijetaret Shafi'i:

**Mendimi i pare:** Qe ai te sqaroje çfare ka thene (kur ka pergojuar) eshte kusht. Keshtu qe nese ai falet pa i treguar atij se çfare ka thene, falja s'eshte e vlefshme, mu sikur ne rastin kur ai do ta falte ate per (vjedhjen) parate qe nuk e di se te kujt jane (e keshtu nuk di se kujt t'ia kthesh).

**Mendimi i dyte:** Te njoftuarit e atij (se çfare ka thene) nuk eshte kusht, sepse kjo eshte diçka qe personi nuk do ta duroje dot e keshtu nuk do t'ia fale. Pra te dije (se çfare ka thene ne detaje) nuk eshte kusht, ne kundershtim me shembullin e parave te vjedhura.

Mendimi i pare eshte me i forte, meqenese njerezit e kane mundesine qe te falin per disa lloje pergojimi e jo per te tjera.

Dhe nese ai qe eshte pergojuar ka vdekur ose nuk eshte i pranishem, atehere nuk ka nevoje te kerkajo falje prej personit. Sidoqofte, dijetaret thone: Ai duhet te beje shume du'a per ate njeri dhe te kerkajo falje per te, dhe te beje vepra te mira.

Dije se eshte e pelqyeshme qe ai qe eshte pergojuar ta pale pergojuesin per ate mekat, por kjo nuk eshte e detyrueshme per te. Kjo per arsyen se kjo eshte ulje dhe humbje e se drejtës se personit, keshtu qe ai mund te zgjedh (ta pale apo mos ta pale pergojuesin). Sidoqofte, eshte me se e rekomandueshme (mure'akkideh) per ate qe t'i pale vellait te tij, qe vellai i tij musliman te jete i lire nga demtimi per shkak te atij mekati dhe te jete i suksesshem ne marrjen e shperblimit, faljes dhe dashurise se Allahut. Allahu, me i larti, thote:

**"Ata qe e mbajne zemerimin dhe i falin njerezit. Vertet, Allahu i do bamiresit".** (Ali Imran: 134)

Menyra me e mire qe ta beje veten qe te pale eshte duke e perkujtuar veten se: "Kjo çeshtje ka ndodhur ne te kaluaren dhe nuk ka mundesi qe kjo te largohet tani. Keshtu qe nuk eshte e drejtë per mua qe ta le ate person pa marre shperblimin dhe pa e falur vellane tim musliman".

Allahu thote:

**"Vertet, kush ben durim dhe fal, atehere kjo eshte nga gjerat e keshilluara nga Allahu".** (esh-Shura: 43)

Dhe Ai thote:

**"Tregohu fales".** (el-A'raf: 199)

Ajete te ngjashme me çfare permendem me larte jane te shumta.

Nje nje hadith sahih, i Derguari i Allahut salallahu alejhi ue selem ka thene: **"Allahu e ndihmon robin e Tij per sa kohe qe robi e ndihmon vellane e tij"**. Transmeton Muslimi 2699

esh-Shafi'i, rahimehullah, ka thene: "Kedo qe mundohesh ta kenaqesh, megjithkete ai nuk kenaqet, ai eshte shejtan".

Njerezit ne te kaluaren recitonin:

"Me thane mua se filani ka folur keq per ty

Dhe kur i riu ka per qellim peruljen, kjo eshte turperim

Keshtu qe thashe: Ai ka ardhur tek ne dhe na ka dhene justifikim

Parate e gjakut (si zhodemtim) per mekatin eshte qe te kerkajo falje".

Pra, çfare kemi permendor ketu ne lidhje me inkurajimin qe njeriu ta pale ate qe e pergojon eshte e sakte. Persa i perket asaj qe eshte transmetuar nga Se'id ibn el-Musejjib se ai ka thene: "Nuk do ta fal ate qe me ka bere zullum", dhe ibn Sirini qe ka thene: "Nuk do t'iad ndaloje atij e pastaj t'iad lejoje, sepse Allahu e ka bere pergojimin haram per te dhe une nuk do te bej hallall diçka qe Allahu e ka bere haram, kurre", atehere kjo ose s'eshte e vertete, ose eshte gabim.

Kjo eshte per arsyen se personi qe fal nje njeri nuk eshte duke e bere haramin hallall. Por, ai vetem e le nje te drejte qe eshte ligjeruar per te. Provat nga Kurani dhe Sunneti tregojne qarte se eshte e rekomandueshme falja dhe lenia e te drejtave personale, te cilat jane te vecanta ne kete rast. Ose ndoshta fjalet e Ibn Sirin do te thone:"Nuk ia lejoj vetes qe te pergojohem, asnjeher". Kjo do te ishte e sakte, sepse nese njeriu thote:"Kerkoi qe nderi te me kthehet nga personi qe me ka pergojuar", ai nuk lejon te behet pergojimi. Madje, ai eshte duke ndaluar çdokend nga pergojimi ndaj tij, ashtu siç ndalon qe te pergojohen te tjeret.

Persa i perket hadithit:**"A nuk mund te behesh si Ebu Demdem - kur ai dilte nga shtepia e tij thoshte: "Po e jap nderin tim sadaka per njerezit"**". Kuptimi: Une nuk do te kerkoj drejtesi per ate qe me ben zullum mua qofte ne dun'ja apo akhiret. Kjo eshte e vlefshme per te larguar nje zullum qe ekzistonte para se te falej, por persa i perket asaj qe ndodh pas kesaj, atehere duhet te kete falje tjeter pas kesaj. Dhe me Allahun qendron i gjithe suksesi.

#### LIDHUR ME THASHETHEMET

Tashme ne e kemi permendor ndalesen e saj e po ashtu edhe provat per kete dhe çka eshte transmetuar lidhur me ndeshkimin per te. Po ashtu permendem perkufizimin e saj, mirepo e gjithe kjo ishte shkurtimisht. Ne do te shtojme tashti me teper ne shpjegimin e saj.

Ebu Hamid el-Ghazali (ra) ka thene:"Ne pjesen me te madhe, thashethemet (nanimah) i veshen atij qe merr theniet nga nje person (lidhur me nje tjeter individ) dhe e kallezon ate tek ai individ per te cilin eshte folur. Nje shembull i kesaj eshte kur ndonjeri thote:**"Ky person tha kete e ate per ty"**. Mirepo, thashethemet nuk jane kufizuar vetem ne kete shembull, por shtrirja e saj eshte: Eksposzimi i asaj qe dikush e urren t'i zbulohet, qofte kur ai nga i cili e kallezon apo ia te cilit ia kallezon apo pesroni i trete e urren ate. Dhe eshte njesoj se a behet ky eksposzimi me ane te te folurit ose me ane te te shkruarit ose me ane te gjesteve, etj, dhe pavaresisht se ajo qe eshte duke u kallezuar ka te beje me fjalet ose veprat e ndonjerit, dhe qofte nese kjo eshte ndonje mangesi ose diçka tjeter pos kesaj. Pra, realiteti i thashethemeve eshte: Perhapja e asaj qe eshte dashur te jete private, dhe shkaterrimi i fshehjes se asaj qe ai urren te ekspozohet.

Njeriu duhet te heshte lidhur me çkado qe ai shikon (ose degjon) nga gjendjet e njerezve, perveç per ate qe ne qofte se e tregon do te kete perfitim per nje Musliman ose do te parandaloje nje mekat te ndodhe".

Dhe ai tha:"Çdonjerit qe i percillen thashetheme (nanimah) dhe i thuhet atij:**'Filan personi e tha kete e kete per ty'**, atehere jane gjashte gjera qe kerkohen nga ai:

1. Ai nuk duhet t'i besoje atij, sepse ai i cili po percjell lajmin eshte njeri qe merret me thashetheme (namam) dhe njeriu i tille eshte njeri i lig (fasik) keshtu qe fjalet e tij refuzohen.
2. Ai duhet ta ndaloje ate ne kete, ta keshilloje ate dhe te shfaqe urrejtje ndaj veprimeve te tij.
3. Ai duhet ta urreje ate per hir te Allahut, se vertet, ai eshte i urryer ne shikimin e Allahut, dhe urrejtja per hir te Allahut eshte nje detyrim.
4. Ai nuk duhet te kete mendime te liga rrith personit nga i cili ai tregon, bazuar ne fjalet e Allahut:**"Menjanoni dyshimet e shumta"**. (el-Huxhurat:12)

5. Çka eshte transmetuar tek juve (rreth dikujt) nuk duhet te shkaktoje qe ju te spiunoni ose te hetoni me tej kete çeshtje, sepse Allahu thote:**"Dhe mos spiunoni njeri-tjetrin"**. (el-Huxhurat:12)

6. Ai nuk duhet te jete i kenaqur me veten e tij ne ate qe ai ka ndaluar per njeriun qe merret me thashetheme. Keshtu qe ai nuk duhet te kallezoje thashethemet qe i jane percjellur atij duke thene:**"Filan personi ma tha mua kete"**, sepse ai do te behej nje njeri qe merret me thashethemeve dhe ai do te kryente ate qe ai ndaloi".

Eshte transmetuar se nje njeri shkoi tek 'Ummer Ibn 'Abdul-Aziz (ra) dhe i tha atij diçka rreth nje personi tjeter. Keshtu, 'Ummar (ra) i tha atij:"Ne qofte se deshiron ne do ta hetojme rastin tend. Ne qofte se ju jeni duke genjyer, atehere ju jeni nga ata qe futen ne ajetin:

**"Ne qofte se nje njeri i lig e i poshter ju vjen me ndonje lajm, atehere verefikojeni ate (lajmin)".** (el-Huxhurat:6)

dhe ne qofte se e thoni te verteten, atehere ju futeni ne ajetin:**"Pergojues, qe bart shpifje (nder njerez)"**. (el-Kalem:11) dhe ne qofte se deshiron mund te mos i kushtojme rendesi kesaj çeshtjeje". Keshtu qe njeriu tha:"Te lutem kaloje ate, o Komandant i Besimtareve! Nuk do ta permend me ate kurre".

<http://xhamiambret.com/>